


## PATRONIMIA E HIMARËS

1. Objekt i këtij punimi, që vjen në vijim të një monografie kushtuar përkatësisë etnike të himarjotëve, është bërë antroponimia e krahinës së Himarës, me synimin që të plotësojmë dhe të thellojmë argumentet që kemi sjellë në veprën në fjalë lidhur me këtë problem.

Meqenëse emri Himarë historikisht ka shënuar njësi të ndryshme etnografike e administrative, së pari e ndiejmë të nevojshme të saktësojmë se me Himarë kuptojmë fshatrat e krahinës së Bregut të Sipërm, d.m.th. Qeparoin, Kudhësin, Pilurin, qytetin e Himarës, Iljazin, Vunoin, Dhërmiun dhe Palasën. Nga pikëpamja administrative, këto fshatra përfshihen në bashkinë e Himarës, e cila varet nga prefektura e Vlorës. Me shtrirje gjatësore përgjatë shpateve perëndimore të maleve të Vetëtimës, bashkia e Himarës kufizohet në veriperëndim me komunën e Dukatit, në veri e lindje me komunën e Vranishtit dhe në jugperëndim me komunën e Lukovës<sup>1</sup>. Nga pikëpamja etnografike, Bregu i Poshtëm dhe Bregu i Sipërm formojnë krahinën e Bregut të Detit, që është një nënndarje e Labërisë<sup>2</sup>.



Bashkia e Himarës

<sup>1</sup> R. Memushaj, *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*, Tiranë, 2004, f. 31.

<sup>2</sup> Për përkatësinë labe të himarjotëve, shih J. G. von Hahn, *Albanesische Studien*, Wien, 1853, S. 15 dhe H. Holland, *Travels in the Ionian Isles, Albania...*, London, 1819, p. 99. Ndër studiuesit shqiptarë, E. Çabej është i vetmi që, megjithëse pranon se kufirin perëndimor të Labërisë e “përbën deti”, shton se Himara «prej disave konsiderohet si krahinë labe, prej të tjerësh si ‘labëronjëse» (“Studime gjuhësore”, V, Prishtinë, 1975, f. 111).

Nga pikëpamja sociolinguistike, krahina e Himarës paraqet një ndër zonat ku haset dukuria e dygjuhësisë. Në këtë trevë, banorët shqip- e greqishtfolës jetojnë në dy enklava, enklava e Himarës dhe enklava e Dhërmi–Palasës, të ndara nga njëra-tjetra prej bashkësisë njëgjuhëse shqipfolëse të Vuno–Iljazit. Këto bashkësi dygjuhëse të Bregut të Sipërm formojnë dy ishuj gjuhësorë të rrethuar prej shqipfolësish njëgjuhës: enklava e Dhërmi–Palasës nga veriperëndimi ka krahinën e Dukatit, nga lindja Tërbaçin e Vranishtin dhe nga jugperëndimi Vunoin e Iljazin; kurse enklava e Himarës në veri kufizohet me Vunoin e Iljazin, në lindje me Kallaratin, Kuçin e Pilurin dhe në juglindje me Kudhësin e Qeparoin, të gjitha me gjuhë amtare shqipen. Madje, edhe brenda këtyre dy enklavave banorët dygjuhës jetojnë të përzier me shqipfolës njëgjuhës, të vendosur në këtë krahinë duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, sidomos dhjetë-pesëmbëdhjetë vjetët e fundit, si rrjedhim i emigrimit të brendshëm.

Prania në krahinën e Himarës e një elementi shqip- e greqishtfolës ka shërbyer për qarqe të caktuara si argument se krahina e Himarës është pakicë etnike greke. Polemika rreth karakterit etnik të Himarës, e ndezur në periudha kritike të historisë së Shqipërisë, vijon edhe në ditët tona. Në këtë shkrim do të mundohemi të thellojmë ndihmesat për të provuar karakterin etnik të himarjotëve, por duke u ndalur në një çështje të veçantë: në onomastikën e Himarës. Para se t’i hyjmë shtjellimit të kësaj teme, duam të saktësojmë që objekt i shqyrtimit tonë do të bëhet jo gjithë onomastika e krahinës, po vetëm patronimet, apo emrat e familjeve, si dhe një pjesë e toponimisë që rrjedh prej tyre. Por edhe këtu do të përqendrohemi më shumë në patronimet e fshatrave dygjuhëse, d.m.th. të Himarës, Dhërmiut dhe të Palasës, meqenëse patronimet e fshatrave njëgjuhëse të kësaj krahine nuk kanë asnjë ndryshim prej të parave.

Korpusi i analizuar përbëhet nga një listë me 145 emra familjesh të Himarës, Dhërmiut e Palasës, e nxjerrë nga regjistri osman i vitit 1583 i kazasë së Kurveleshit të sanxhakut të Delvinës<sup>3</sup>; nga një listë e vitit 1791 me emrat e familjeve të po këtyre tri fshatrave<sup>4</sup>, e cila përmban 59 njësi; nga të dhënat e mbledhura aty nga mesi i viteve ‘90 të shekullit të kaluar prej qemtuesit të apasionuar të traditës së Labërisë Bardhosh Gaçe, i cili pati mirësinë të m’i vinte në dispozicion këto të dhëna; dhe nga listat zgjedhore të tetorit të vitit 2003 për bashkinë e Himarës, prej të cilave kemi vjelë rreth 750 emra familjesh himarjote vendëse, duke lënë emrat e familjeve të ardhura në qytetin e Himarës shekullin e kaluar.

2. Onomastika përbën një ndër shtresat gjuhësore me vlerë të paçmuar për historinë dhe gjuhën e një etnie. Për këtë arsye studimi i emrave të përveçëm të njerëzve dhe i emërtimeve të vendeve merr një rëndësi të veçantë. Qëllimi i studimit të onomastikës është i dyfishtë: ai synon të vendosë lidhjen e emrave dhe të emërtimeve të përveçme me bashkësinë që i përdor dhe lidhjen e këtyre emërtimeve me leksikun e përgjithshëm të gjuhës<sup>5</sup>. Në rastin e parë, studimi jep të dhëna për prejardhjen e popullsisë së një treve, për historinë e saj, për mënyrën e punës dhe të jetesës, për zakonet dhe religjionin e saj, për veçoritë e relievit ku ajo është vendosur etj. Studimi i lidhjeve të emrave të përveçëm vetjakë e familjarë dhe të emërtimeve të përveçme me leksikun e përgjithshëm ka si detyrë të përcaktojë shkallën e pasqyrit të thesarit leksikor të një bashkësie në onomastikën e saj, por edhe të nxjerrë të dhëna për historinë e gjuhës së asaj bashkësie.

<sup>3</sup> Të dhënat për vitin 1583 për fshatrat Himarë, Palasë dhe Dhërmi na i vuri në dispozicion prof. P. Thëngjilli, i cili i ka përkthyer ato nga Defter-i mufassal liva-i Delvina, nr. 91, viti 1583, fl. 66 (Himara) dhe fl. 74 (Palasa e Dhërmiu).

<sup>4</sup> S. Rusha, *Himara në stuhitë e shekujve*, Tiranë, 2001, f. 153-155.

<sup>5</sup> *Principii toponimiki*, Akademiya Nauk SSSR, Moskva, 1966, s. 45.

Nga natyra e vet, antroponimet dhe toponimet dallojnë rrënjësisht prej emrave të përgjithshëm, pasi këta të fundit, si pjesë e leksikut të përgjithshëm, kanë funksion përgjithësues, klasifikues, duke u përdorur për një numër të madh frymorësh ose jofrymorësh të së njëjtës klasë. Kurse emrat e përveçëm dhe emërtimet e përveçme kanë si funksion themelor thjesht shënimin, individualizimin e frymorëve dhe të objekteve, vënien e një etikete çdonjërit prej tyre, me qëllim që individi apo objekti i emërtuar të identifikohet e të dallohet me lehtësi prej individëve apo objekteve të tjera të asaj klase<sup>6</sup>.

Meqë përgjithësimi nënkupton krijimin e koncepteve për klasa frymorësh dhe objektesh, kjo do të thotë që përmbajtja e emrave të përgjithshëm ndryshon me ndryshimin e koncepteve që ata shënojnë, pasi njohja e njeriut nuk ka kufi. Emrat e përveçëm, meqenëse nuk shënojnë koncepte, nuk kanë as përmbajtje, kështu që ndryshojnë më pak dhe më ngadalë, ngaqë nuk ka arsye të brendshme, gjuhësore për ndryshimin e tyre. Kjo qëndrueshmëri e emrave të përveçëm shpjegohet me thelbin e tyre, me atë që këta emra nuk kanë lidhje të ngushtë me frymorët dhe objektet që emërtojnë, pasi shërbejnë thjesht si etiketa për dallimin e një individi, të një grupi apo të një njësie nga individët, grupet apo njësitë e tjera. Si të tillë, ata mund të përdoren nga dhjetëra e dhjetëra breza për individë dhe objekte të reja.

Por kjo nuk do të thotë që emrat e përveçëm janë përjetësisht të pandryshueshëm. Edhe ata ndryshojnë: për shkaqe religjioze, politike, ideologjike, të modës etj., shtresa të tëra emrash të përveçëm mund të dalin nga përdorimi dhe të zëvendësohen me emra të tjerë, siç ka ndodhur jo një herë në historinë e popullit tonë. Mirëpo, edhe kur veprimi i faktorëve të mësipërm është shumë i fortë, shtresa të tëra antroponimesh, sidomos ato që lidhen me anët më të qenësishme të një bashkësie gjuhësore, me mënyrën e jetesës dhe me kulturën shpirtërore e materiale të saj, ruhen të paprekura. Pikërisht, me këtë shpjegohet pse antroponimet përbëjnë një nga shtresat gjuhësore më me interes për të provuar përkatësinë etnike dhe karakterin autokton apo alokton të një grupi të caktuar etnik.

Çdo bashkësi dallon nga të tjerat edhe për mënyrën se nga i merr dhe si i ndërton emrat dhe emërtimet e përveçme, dhe kjo përbën një fushë tjetër që duhet hulumtuar. Jo pa interes janë edhe veçoritë gjuhësore të këtyre njësive: veçoritë formale gramatikore dhe sidomos ndryshimet fonetike që kanë pësuar. Duke kaluar në gojën e dhjetëra e dhjetëra brezave, emrat e përveçëm dhe emrat e vendeve doemos që pësojnë ndryshime tingullore, nën veprimin e rregullave fonetike të gjuhës së cilës i përkasin. Emrat me një moshë tepër të vjetër bartin me vete pasojat e rregullave fonetike që kanë vepruar mbi ta në epoka të ndryshme të jetës së tyre. Kështu që studimi i ndryshimeve tingullore bën të mundur të zbulohen rregullat që i kanë shkaktuar dhe të bëhet një kronologjizim i këtyre rregullave, i cili, nga ana e vet, merr vlerë për përcaktimin e moshës së këtyre njësive.

Veç këtyre ndryshimeve spontane, të pavetëdijshme të formës, ka edhe të tjera që e kanë burimin në përpjekjet e vetëdijshme të anëtarëve të bashkësisë së cilës i përkasin këto emërtime. Lidhja arbitrare me frymorët dhe objektet që emërtojnë përbën “thembrën e Akilit” të emrave të përveçëm vetjakë, të emrave të familjeve dhe të toponimeve. Duke mos pasur lidhje të ngushta me objektet që emërtojnë, ato mund t’i nënshtrohen ndërhyrjes së njeriut, i cili, në mënyrë të vetëdijshme, mund t’i ndryshojë dhe t’i zëvendësojë me emërtime të tjera, siç ndodh gjatë periudhave të pushtimeve, kur një bashkësi ndërron besimin e vet apo kur individi a bashkësia, për një arsye ose për një tjetër, kërkojnë ndryshimin e emërtimeve të vjetra. Kësaj ndërhyrjeje i nënshtrohen sidomos emrat e përveçëm vetjakë, por në një shkallë më të vogël edhe patronimet dhe toponimet. Një tjetër shkak i ndryshimeve të vetëdijshme është etimologjia popullore. Kureshtja i shtyn njerëzit të dinë kuptimin e toponimit apo të patronimit, sepse, në fund të fundit, këto janë fjalë të gjuhës. Duke e lidhur formën tingullore të tyre me fjalë me kuptim të gjuhës, pra duke u përpjekur t’u japë një kuptim fjalëve pa

---

<sup>6</sup> Ç. Bidollari, *Emri i përveçëm vetjak: semantika dhe morfologjia*, SF, 2000, nr. 1–2, f. 148.

kuptim, etimologjia popullore ka shpënë në ndryshimin e formës së emrave dhe të emërtimeve të përveçme. Në raste të tjera, për të fshehur kuptimin e emërtimeve prej emrash me kuptime të këqija ose me ngjyime kuptimore përkeqësuese, u është ndryshuar qëllimisht forma patronimeve ose toponimeve. Gjurmë të kësaj ndërhyrjeje të vetëdijshme gjenden gjithandej dhe me shumicë në onomastikën shqiptare.

3. Patronimet, ose emrat e familjeve, përbëjnë një nga pjesët më të qëndrueshme të thesarit onomastik, pasi, meqenëse nuk lidhen me individë të veçantë, që rrojnë jo më shumë se tre breza, po me grupe individësh të shumë brezave të cilët i bashkon pikërisht prejardhja nga një i parë i përbashkët, ato ruhen më gjatë në gjuhë, duke ndryshuar vetëm për arsye shumë të forta. Si të tilla, ato marrin një vlerë të veçantë, pasi, duke u mbështetur në to, mund të nxjerrim të dhëna të rëndësishme për historinë, për besimin dhe për mënyrën e jetesës së një bashkësie.

Shqyrtimi i lëndës onomastike të fshatrave dygjuhëse të Himarës do të bëhet në dy plane: në planin sinkronik, me qëllim që të zbulohen veçoritë strukturore të këtyre njësive, dhe në planin diakronik për të parë vijimësinë e emërtimeve dhe të gjedheve derivuese të tyre. Trajtimi diakronik i lëndës është më i vështiri, pasi jo gjithnjë forma në të cilën shfaqen këto emërtime lejon të zbulohet prejardhja e tyre. Në vështirimin sinkronik, emrat e familjeve do të shqyrtohen nga disa këndvështrime: nga pikëpamja e strukturës, e gjedhes fjalëformuese, e veçorive gramatikore dhe fonetike.

Duke i parë nga pikëpamja e strukturës, patronimet e fshatrave të Himarës mund të ndahen në dy grupe të mëdha: njëfjalëshe dhe dyfjalëshe. Sikurse është vënë në dukje nga studiues shqiptarë dhe të huaj, në popullin tonë ka qenë i përhapur gjerësisht individualizimi “vetëm me anë të një emri të veçantë tjetër, duke u përdorur përgjithësisht si emër familjeje emri vetjak i babait ose i gjyshit”<sup>7</sup>. Edhe në fshatrat e Himarës emërtimet dygjymtyrëshe të tipit A + B, ku A është emri i përveçëm vetjak dhe B emri i babait ose i gjyshit, përbëjnë modelin më prodhues.

Në të kaluarën, në këtë trevë ishte zakon përdorimi sidomos i emrit vetjak dhe i emrit të babait. Një dëshmi të kësaj tradite në fshatrat e Himarës na e sjell H. Kuçuli në shkrimin “Sprovë për studimin e emrave të familjeve...” Sipas tij, një dhërmias i quajtur Athanas Gjika, oficer në shërbim të mbretërisë së Napolit, ka lënë në shtëpinë e tij një pllakë që mban datën 20 janar 1765, në të cilën është shënuar gjenealogjia e familjes deri në tetë breza para tij, d.m.th gjer aty nga fillimi i shek. XVI. Aty shihet se të parët e çdo brezi kanë si mbiemër emrin e babait të tyre: i pari *Vreto*, i dyti *Petro Vreto*, i treti *Gliza Petro*, i katërti *Gusta Gliza*, i pesti *Strati Gusta*, i gjashti *Nikolo Strati*, i shtati *Gjika Nikolo* dhe i teti *Athanas Gjika*<sup>8</sup>. Kjo praktikë ndiqet kur numërohen brezat në gjithë Labërinë. P.sh., në Kallarë, që i përket Labërisë së brendshme, pleqtë i tregonin kështu brezat e fisit Gjokon: *Dervish Aliko* (?–1847), *Aliko Toto*, *Toto Qejvani*, *Qejvan Amati*, *Amat Qesari*, *Qesar Gjoka*, *Gjokë Gjika*, *Gjikë Gjoka*, *Gjokë Kondi*.

Emra të tipit A + B mbajnë edhe shumë himarjotë që përmenden në dokumente historike të periudhës së parë të pushtimit turk, si Jorgji Zaho (1458–1550) nga Himara, Kosta Dhimo (1482–1537) nga Palasa, alias Iliaz Pasha, gjeneral i sulltanit; Gergj Konda, Manol Klada e Dhimitër Klada, të tre me prejardhje nga Himara, që më 1555 janë komandantë stratiotësh; Mërkur Bua nga Dhërmiu (shek. XV–XVI); më 1577, Nikollë Gjika e Gjergj Katasi nga Himara; Jovan Leksi më 1581; Korteza Bana (?–1597) nga Himara, nxënës i kolegjit grek dhe

---

<sup>7</sup> Po aty, f. 154.

<sup>8</sup> H. Kuçuli, *Sprovë për studimin e emrave të familjeve në rrethin e Vlorës*, në “Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të prof. dr. Aleksandër Xhuvanit”, Tiranë, 1986, f. 454.

shumë e shumë të tjerë<sup>9</sup>. Shumica dërrmuese e emrave të regjistrit turk të vitit 1583 janë të këtij tipi, siç mund të shihet nga lista e emrave në fund të punimit. Po lidhur me atë se ç'përfaqësojnë këto patronime, emrin e babait, emrin e gjyshit apo emrin e familjes, është e vështirë të jepet një përgjigje e prerë.

Ndryshe ndodh në ditët tona, kur në zyrat e gjendjes civile ndër të dhënat anagrafike të të porsalindurve përfshihen emri vetjak, emri i babait dhe emri i familjes. Si rrjedhim, tradita që po mbizotëron është ajo e individualizimit me anë të emrit vetjak dhe të emrit të familjes, traditë që zë fill me krijimin e shtetit kombëtar dhe të administratës shqiptare, ndonëse në disa dokumente shënohet edhe emri i babait.

Patronimet njëfjalëshe mund të shihen më tej edhe nga pikëpamja e motivimit për të gjetur fjalët që qëndrojnë në bazën e tyre. Sipas këtij këndvështrimi, brenda këtij grupi mund të dallohen disa klasa.

Ndër patronimet e këtyre fshatrave vendin e parë e zënë ato patronime njëfjalëshe që vijnë nga një emër i përveçëm vetjak. Brenda kësaj klase emrash, që përbën edhe grupin më të madh, dallohen emra vetjakë shtresash të ndryshme historike dhe me prejardhje të ndryshme.

Një grup të veçantë formojnë patronimet nga emra personash historikë të botës iliro-arbëreshe<sup>10</sup>, ky hyjnë emrat *Leka* (emri shqiptar i Aleksandrit të Madh), *Piro*, *Qezar* dhe *Kommen*, nga të cilët *Piro* dhe *Kommen* dalin vetëm në regjistrin turk të vitit 1583, ndërsa *Leka* dhe *Qezar* dalin më 1583, më 1791 dhe më 2003, gjë që flet për një vijimësi të pandërprerë të tyre në gojën e banorëve të krahinës. Ndonëse të paktë në numër, këta emra familjesh marrin një rëndësi të veçantë për të gjykuar për karakterin etnik të banorëve të këtyre fshatrave. Një vend të veçantë ndër patronimet prej emrash të përveçëm vetjakë zënë edhe disa emra të tjerë të vjetër, si *Lika*, *Deda*, *Marta*, *Zoto*, *Premti*, *Pali*, të cilët vijnë nga bota ilire pagane dhe kristiane e hershme. Shumica e këtyre emrave, të dokumentuar që nga viti 1583, jetojnë si patronime edhe sot e gjithë ditën në krahinën e Himarës.

Një grup të madh brenda kësaj klase formojnë patronimet prej emrash shqiptarë, pjesa më e madhe e të cilëve nuk përdoren më si emra vetjakë, si: *Baka*, *Ballamo*, *Beli*, *Beno*, *Beruka*, *Brigo*, *Bifsha*, *Billa*, *Boçi*, *Biça*, *Biti*, *Burbo/Burba*, *Bixha*, *Bixhili*, *Boci*, *Brame*, *Brigo*, *Cani*, *Cura*, *Çako*, *Çini*, *Çomora*, *Doja*, *Dumo*, *Dani*, *Dina*, *Duni*, *Dini*, *Doko*, *Dhamo*, *Dhima*, *Dhrami*, *Dhrako*, *Goro*, *Grillo*, *Guga*, *Guma*, *Gjezo*, *Gjika*, *Gjoka*, *Meniko*, *Menkuli*, *Hila*, *Janilaj*, *Joshi*, *Kaçi*, *Kapo*, *Koçi*, *Kola*, *Kondi*, *Leondar*, *Loli*, *Lluka*, *Luçi*, *Luta*, *Marini*, *Memi*, *Mile*, *Miti*, *Mitri*, *Mujo*, *Muka*, *Muso*, *Nasaj*, *Ndreri*, *Nina/Nini*, *Nika*, *Nushi*, *Paço*, *Peçi*, *Qesko*, *Reçi*, *Rusha*, *Ruci*, *Skura*, *Soro*, *Shanto*, *Treko*, *Thimi*, *Vengo*, *Vjero*, *Vlash*, *Vreto*, *Xani*, *Xhili*, *Xhuvëli*, *Zakna*, *Zhupa*, *Zhebo*, *Zhaku* etj.

Një grup tjetër e formojnë patronimet që rrjedhin prej emrash kristianë të botës romako-bizantine. Një pjesë e këtyre dalin në forma të asimiluara dhe, si pasojë, u dallohet me vështirësi tema bazë, si: *Çaçi* (Anastas), *Damo/Dhamo* (Damian), *Dhima* (Dhimitër), *Gjon* (Johan), *Gjergji* (Georgius), *Gjini*, *Gjoni* (Joannes), *Jorgji* (Georgius), *Kosta* (Kostandin), *Mitri* (Dhimitër), *Lazri/Lazraj* (Llazar), *Milo* (Mëhill), *Mërtiri* (Martin), *Naçi* (Thanas), *Nasho* (Anastas), *Ndreri* (Andrea), *Neço* (Nestur), *Pani*, *Pano* (Panajot), *Polo* (Napoleon), *Stefa* (Stefan), *Zaho* (Zaharia), *Todhri* (Teodor) etj.

Shumë prej këtyre emrave kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve, të cilët kanë arritur të japin shpjegime bindëse për vjetërsinë e tyre. Kështu, emri *Pal* prej lat. *Paulus*, ka shumë gjasa të jetë marrë nga kaonët prej romakëve para lindjes së krishterimit, megjithëse nuk përjashtohet lidhja edhe me emrin e Shën Palit, predikuesit të kësaj feje në Epir. Ndonëse ky

<sup>9</sup> R. Memushaj, *vep e për.*, f. 116; shih edhe N. Borgia, *I monaci basiliani d'Italia in Albania*, Roma, 1935, p. 13, 20; Po ai, *I monaci basiliani .....*, 1942, p. 59.

<sup>10</sup> Këtu fjalën "arbëresh" e përdorim për të shënuar shqiptarët e vjetër, para shek. XVIII.

emër i përket gjithë botës së krishterë, trajta *Pal* nuk gjendet në asnjë gjuhë tjetër përveç shqipes<sup>11</sup>.

Edhe emrat *Gjon* e *Gjin*, të dy prej lat. *Jo(h)annes*, që i përkasin shtresës së vjetër të shqipes, janë shumë të përhapur në trevën e Himarës dhe në Labërinë prapa maleve. Përveç dokumenteve historike, vjetërsinë e tyre e tregojnë edhe format fonetike të ngulitura qysh herët si dhe përdorimi në përbërje të patronimeve-kompozita. Sidomos trajta *Gjon* na dëshmon disa ndryshime fonetike, si: shpërngulja e theksit mbi rrokjen e parë, rënia e zanores *a* të togut *oa*, si dhe kalimi *j>gj*. Prej këtyre, theksimi mbi rrokjen e parë është një dukuri shumë e vjetër e shqipes<sup>12</sup>; sipas **Sh.** Demirajt, edhe shndërrimi *j>gj* «dëshmon për vjetërsinë e depërtimit të këtij emri te stërgjyshërit e shqiptarëve»<sup>13</sup>.

Emri *Gjergj*, prej lat. *Georgius*, hyn gjithashtu në fondin e emrave shumë të përhapur të shqipes. Ai gjendet si në Himarë, edhe në Labërinë prapa maleve, si emër shenjtori, kishash, në toponimi dhe në patronimi. Për vjetërsinë e tij dëshmojnë qiellzorizimi i *g* në *gj* dhe sidomos shqiptimi me theks mbi zanoren *e* dhe jo mbi *o* si në gjuhët e tjera<sup>14</sup>. Pra, *Gjergj* hyn ndër huazimet e shtresës së vjetër tek të cilat ka ndodhur zhvendosja e theksit mbi rrokjen e parë, sipas një rregulle fonetike të vjetër të shqipes që pushoi së vepruari në periudhën e kontakteve të dendura të shqipes me latinishten.

Emra të fondit shumë të vjetër të krishterë, që i kanë shpëtuar vëmendjes së studiuesve mendojmë se janë edhe *Lazër* e *Todhër*, që gjenden në Himarë dhe në Labërinë e brendshme. Tek emri *Lazër* (prej *Lazar*) kemi zhvendosjen e theksit mbi rrokjen e parë të fjalës dhe errësimin në *ë* të zanores *a* që mbetet jashtë theksit, dukuri gjithashtu të vjetra të kohës parasllave. Edhe tek *Todhër* (prej *Teodor*) kemi rënien e zanores *e* dhe pastaj theksimin mbi rrokjen e parë, ndryshe nga gjuhët e tjera ku theksi bie mbi *o*-në e dytë, errësimin në *ë* të zanores *o* që mbetet jashtë theksit si dhe kthimin e *d* në *dh*. Nga këto dukuri, siç u vu në dukje më sipër, theksimi në rrokjen e parë të fjalës përbën një tipar të huazimeve të periudhës së hershme.

Të një moshe disi më të re janë emra si *Mërtir*, *Ndre(ri)* etj. Te *Mërtir* (prej *Martin*) kemi reduktimin e zanores *a* në *ë* dhe rotacizmin *n>r*, që dëshmojnë për moshën relativisht të hershme të tij. Por ruajtja e theksit mbi rrokjen e dytë tregon se ky emër ka hyrë në përdorim më vonë se emrat *Pal*, *Gjon*, *Gjin*, *Gjergj* e *Lazër*, gjithsesi në periudhën para depërtimit të sllavizmave në shqipen<sup>15</sup>. Te *Ndreri* (nga *Andrea*), rënia e zanores nistore *a* dëshmon për theksimin jonistor të fjalës dhe për moshën e njëjtë me *Mërtir*. Veç zanores nistore *a*, ka rënë edhe fundorja *a*, kështu që në shqipe tema e këtij emri u bë *Ndre* dhe trajta e shquar *Ndre-u*, që na dëshmohet sot në Veri. Mirëpo, ndërsa pritej që emri i familjes të ishte *Ndrea*, d.m.th. me prapashtesën patronimike *-aj*, kemi trajtën *Ndreraj*. Nuk jemi të sigurt në kemi të bëjmë këtu me një *r* epentetike, të shtuar për lehtësi shqiptimi, apo me një rindërtim analogjik të emrit të përveçëm nën ndikimin e *dre-dre-ri*, me të cilin etimologjia popullore duket se e ka lidhur këtë emër, pra që në një periudhë të mëvonshme emri vetjak ta ketë bërë të shquarën si emri *dre: Ndre-Ndre-ri*.

Vjetërsinë e emrave të mësipërm në trevën e Himarës dhe në gjithë Labërinë e tregojnë jo vetëm dukuritë fonetike të shkaktuara nga rregulla fonetike që kanë pushuar së vepruari qysh herët, po dhe përdorimi i tyre gjer para disa shekujsh edhe si emra, edhe si patronime, dhe veçanërisht përfshirja e tyre në patronime-kompozita, ku kanë pësuar edhe ndryshime të tjera

<sup>11</sup> Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 110.

<sup>12</sup> S. Mansaku, *Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë*, SF, 1982, 3, f. 108.

<sup>13</sup> Sh. Demiraj, *vep. e përm.*, f. 117.

<sup>14</sup> *Po aty*, f. 113.

<sup>15</sup> *Po aty*, f. 121.

fonetike që janë gjithashtu të lashta, p.sh.: *Gjipali* (<Gjin Pali), që dëshmohet qysh më 1583, apo *Gjiçali*, *Gjidede*, *Gjiknuri*, *Gjikoka*, *Gjikondi*, *Gjikuria*, *Gjilaçi*, *Gjinuci* etj.; *Gjodede* (<Gjon Deda), *Gjokushi*, *Gjomemo*, *Gjovasho* etj. Lidhur me shtrirjen e këtyre emrave, lënda onomastike që kemi në shqyrtim tregon se pohimet që disa prej këtyre emrave mbizotërojnë në Veri të vendit e disa në Jug nuk i qëndrojnë së vërtetës. Në Himarë e Labëri gjenden pothuajse po ato emërtime si në Veri të vendit.

Pjesa tjetër e patronimeve janë emra gjithashtu të botës së krishterë bizantino-greke, që nuk e kanë ndryshuar fare formën fillestare ose që kanë pësuar ndryshime të vogla fonetike dhe njihen pa vështirësi si të tilla. Këtu përfshihen patronimet *Aleksi*, *Andoni* (Antonius), *Andrea*, *Apostoli*, *Athanasi*, *Ilija*, *Konomi*, *Kristofori*, *Llazari*, *Manoli*, *Martini*, *Mihali*, *Nikolla*, *Paskali*, *Pavli*, *Thanasi*, *Theodhori/Todori*, *Vasili* etj. Moshën më të re të këtyre emrave në krahasim me emrat e vjetër të botës kristiane e tregojnë trajtat pa ndryshime fonetike të këtyre të fundit, gjë që duket qartë kur krahasojmë *Ndre* dhe *Andrea*, *Mërtir* dhe *Martin*, *Todhër* dhe *Teodor* etj.

Në këtë grup mund të futen edhe një numër patronimesh nga emra të përveçëm vetjakë të huaj. Numrin më të madh të tyre e përbëjnë ato me prejardhje greke, si: *Dhimaqi*, *Jorgo*, *Jorgonllu*, *Mihallo*, *Panajoti*, *Panomllu*, *Stimaqi*, *Anagnosti*, *Dhimitraqi*, *Dhimolea*, *Foto*, *Harito*, *Janaqi*, *Janila*, *Jorjani*, *Jovani*, *Karali*, *Llambro*, *Llanduri*, *Marko*, *Odhisea*, *Panajoti*, *Pavlo*, *Proto*, *Polimeri*, *Stavro*, *Stefani*, *Stimaqi*, *Stolaj*, *Triandafillu* dhe *Trolaj*. Pas këtyre për nga numri vijnë patronimet me prejardhje turke, si *Zylkadër*, *Suvari*, *Sinani*, *Adeti*, *Ajas*, *Dumani*, që janë të vitit 1583, dhe të sotmet *Basha/Bashi*, *Beja*, *Beleri*, *Hiso/Hisa*, *Zendelaj*, *Rexho/Rexha*, *Merxhani* dhe *Muçi/Muço*, të cilat, siç shihet, paraqiten në trajta të asimiluara. Nuk mungojnë edhe patronime prej emrash vetjakë gjuhësh të tjera, si *Averbah* e *Davidhi/Dividhi* nga hebraishtja e vjetër dhe *Kolumba*, *Mikeli*, *Vito*, *Rondo*, *Kaçelano*, *Karavella* e ndonjë tjetër prej gjuhëve romane.

Lidhur me vendin që zënë emrat e huaj të familjeve në numrin e përgjithshëm të patronimeve të Himarës, duhet thënë se nuk është i madh. Më 1583, vetëm shtatë emra familjesh janë fjalë greke dhe pesë turke; më 1791, vetëm pesë nga 59 patronime; dhe, më 2003, rreth 40 patronime mund të merren si fjalë greke, dy hebreje, dy prej gjuhëve romane dhe tetë turke, pra diçka më pak se 7 për qind e antroponimeve të sotme të krahinës. Pra, pesha specifike e elementit të huaj në patroniminë e kësaj treve ka mbetur pothuajse e pandryshuar dhe e papërfillshme në shekuj.

Për më tepër, nuk mund të thuhet se bartësit e patronimeve me prejardhje të huaj janë të huaj, përveç atëherë kur për këtë ka të dhëna të sigurta, siç është rasti i *Averbahëve* në Dhërmi dhe i *Konomajve* (por jo i *Konomëve*), *Stolajve* e *Trolajve* në Himarë, të cilët janë të ardhur nga zona minoritare brenda Shqipërisë<sup>16</sup>. Një arsye tjetër për ta kundërshtuar mendimin se bartësit e këtyre patronimeve nuk janë shqiptarë, është se shumë nga emrat e huaj të familjeve hasen edhe në treva të brendshme të vendit, ku nuk mund të bëhet kurrsesi fjalë për prani të popullsisë aloktone. Ato kanë hyrë nën ndikimin e kishës ortodokse, e cila liturgjitë dhe shërbesat fetare i kryente në gjuhën greke.

Nuk mungojnë në patroniminë e fshatrave në fjalë edhe një grup njësisish që rrjedhin nga emra vendesh, si *Brati* (që mund të jetë edhe emër fisi), *Kuçi*, *Kudhës*, *Melani*, *Zagori* e *Velço*, por pesha e këtyre emrave në numrin e përgjithshëm të patronimeve të kësaj krahine është e papërfillshme. Lidhur me këta emra familjesh, është për t'u vënë në dukje edhe se, me përjashtim të *Kuçi* dhe *Velço*, gjithë të tjerët dalin vetëm në regjistrin e vitit 1583. Kjo shpjegohet me atë që tradita e vjetër e ruajtjes së emrit të fshatit a të krahinës së zanafillës ka

---

<sup>16</sup> Shih R. Memushaj, *vep. e për.*, f. 124–125. Prapashtesa *-aj* e patronimeve që i kemi marrë si të huaja, flet ose për një ndikim të fuqishëm të shqipes, ose për atë që pohimi se bartësit e tyre nuk janë shqiptarë, duhet marrë me shumë rezervë.

vepruar zakonisht kur dikush vendosej në qendra të mëdha të banuara apo largohet shumë nga vendlindja<sup>17</sup>. Pikërisht, emra të tillë familjesh dëshmojnë tek të mërguarit nga Himara, si tek arbëreshët e Italisë, ku gjejmë patronimet *Skutarjoti* (emri i një familjeje me prejardhje nga fshati Skutara i Himarës, i shkatërruar nga tërmeti i vitit 1410) dhe në Sicili më 1568 *Dirmi* e *Pilora/Pillora*<sup>18</sup>.

Një klasë tjetër të pasur formojnë patronimet që rrjedhin prej emrash të përgjithshëm, mbiemrash e ndonjë pjese tjetër të ligjëratës. Ndër ta, vendin kryesor e zënë patronimet e formuara prej apelativësh që emërtojnë njerëz, pjesë trupi, qenie e bimë, dukuri të natyrës etj. Patronime me bazë emra të përgjithshëm njerëzish janë: *Baba/Babe*, *Bonjako*, *Buco*, *Çeço*, *Duka/Dukaj*, *Kasneci*, *Mamija*, *Plaku* etj.; patronime që shënojnë emërtime shkallësh në hierarkinë fetare, si: *Papa*, *Prifti*, *Dhjako* e *Konomi*; disa të tjerë rrjedhin nga fusha e besimeve pagane, si *Marta*, *Zoto/Zota*, *Premti* (nga Shën Prenë, shenjtore e shqiptarëve); patronime prej emrash që shënojnë pjesë të trupit të njeriut: *Balla*, *Karo/Karaj*, *Kocka*, *Koka/Kokaj*, *Mboqe*; prej fjalësh që emërtojnë qenie: *Bica*, *Bua/Boit*, *Bufi*, *Bulla*, *Bullano*, *Bollanaj*, *Çakalli*, *Dacaj*, *Demi*, *Demka*, *Ndreri*, *Nerënxi*, *Pelikani*, *Pula/Pulo*; prej emrash të sendeve, si: *Burgo*, *Boro*, *Çulla*, *Guri*, *Kashta*, *Kosi*, *Kuli/Kule*, *Kumi*, *Lapa*, *Lati*, *Mali/Malo/Malaj*, *Lule*, *Mërkuri*, *Palloshi*, *Rapo/Rapaj*, *Sheti/Sheto* (shumës i “shat”?), *Shia*, *Shuli*, *Vello*; prej emrash abstraktë, si: *Jeto*, *Mai*, *Noti/Nota/Notaj/Note*, *Qendri/Qendraj*, *Vera*, *Veruari*, *Zboga/Zbogo*; prej mbiemrash, si: *Bardhi*, *Buta/Butaj*, *Çali*, *Kreku/Kreka*, *Shkurti/Shkuraj*, *Varfi/Varfaj*, *Vogli*, *Vongli*, *Zi*; dhe prej ndajfoljesh: *Kuri*, *Kote*.

Këto emërtime janë kryesisht nofka që kanë mbetur si emra familjesh për arsye nga më të ndryshmet. Përgjithësisht, emërtimi është bërë duke u mbështetur në një tipar që i ka dalluar të parët e tyre dhe që lidhet me të meta a tipare të spikatura fizike, me cilësi shpirtërore, me gjendjen familjare, shoqërore a ekonomike, me mjeshtëritë që ushtronin, me vendin ku i ushtronin këto mjeshtëri etj. Kështu, patronimet që kanë si bazë emërtimi emra kafshësh shtëpiake shpjegohen me atë që të parët e familjes a të fisit janë marrë me rritjen e këtyre kafshëve, ose, kur janë emra kafshësh të egra, janë marrë me gjuetinë e tyre; ato që lidhen me emra bimësh shpjegohen me atë që të parët e këtyre familjeve janë marrë me kultivimin dhe tregtimin e këtyre kulturave<sup>19</sup>. Por hetimi i motivimit të këtyre emërtimeve jo gjithnjë është një punë e lehtë; të shumtën e herëve shpjegime të tilla nuk mund të jenë tjetër veçse hamendje që qëndrojnë larg së vërtetës, e cila është shumë e vështirë për të mos thënë e pamundur të gjendet<sup>20</sup>.

4. Një tip shumë prodhues në antroponiminë e fshatrave në fjalë përbëjnë patronimet e formuara nga zgjerimi me anë të prapashtesimit i një emri të përveçëm. Shumica e këtyre formanteve janë ndajshitesa të shqipes, por nuk mungojnë edhe prapashtesa të huaja. Ndër prapashtesat shqipe që hasen në patronimet e fshatrave në fjalë janë: *-aj*, *-açi*, *-al(i)*, *-an(i)*, -

<sup>17</sup> Të tilla patronime herë-herë kanë më fort vlerën e një epiteti, si *Neço Muka Himarjoti*, ku “himarjoti” është përdorur prej këtij lëvruesi të këngës himarjote jo me vlerën e patronimit, po për të vënë në pah përkatësinë krahinore të tij.

<sup>18</sup> Shih R. Memushaj, *vep. e për.*, f. 119–120. Këta emra vijnë vetëm nga Hora e Arbëreshëve, gjë që na lejon të mendojmë se tek arbëreshët e Italisë duhet të ketë edhe më shumë patronime të tilla nga Himara.

<sup>19</sup> Më hollësisht për motivimin e patronimeve të trevës së Vlorës, shih H. Kuçuli, *Sprovë për studimin e emrave të familjeve në rrethin e Vlorës*, f. 455.

<sup>20</sup> Si patronime që nuk kemi mundur t’i shpjegojmë, janë *Boli*, *Bokollo*, *Gali*, *Gjizo*, *Gjora*, *Karmeni*, *Katiu*, *Keka*, *Kicani*, *Kisi*, *Lami*, *Lani*, *Lindo* e *Llaguri* dhe mjaft nga ato të regjistrit të vitit 1583, si: *Alemdari*, *Bero*, *Bukali*, *Deliro*, *Dermali*, *Emelkuri*, *Gjorzaj*, *Gjuhamoli*, *Jari*, *Kondavik*, *Kostri*, *Leondari*, *Levendari*, *Lihamoqi*, *Lihor*, *Livrani*, *Lohomo*, *Llanka*, *Madhima*, *Mandashi*, *Mavllari*, *Medrosi*, *Menko*, *Mirini*, *Musiça*, *Musuni*, *Nenko*, *Panuçi*, *Pavllari*, *Sallaja*, *Strelia* e *Ulmi*. Nuk përjashtohet që trajtat në të cilat na paraqiten disa prej këtyre emrave të rrjedhin nga gabimet e nëpunësit që ka bërë regjistrimin, ose edhe nga pasiguria e përkthyesit.

*ar(i)*, *-çe*, *-ko*, *-uc(i)*, *-ul(i)*, *-osh(i)* dhe *-ush(i)*; kurse të huaja janë prapashtesat greke *-adhi*, *-ella* e *-opulli*; turke *-llari*, *-çi* e *-xhi* dhe romane *-ino*.

Më prodhuese ndër prapashtesat shqipe është *-aj*, me të cilën formohen patronime nga tema të thjeshta, si: *Bollanaj* (bollan), *Butaj* (e butë), *Daflaj* (?), *Dhimaj* (Dhimë), *Çullaj* (çull), *Gumaj*, *Gjikaj* (Gjikë), *Gjokaj* (Gjokë), *Karaj* (Karo), *Kokaj* (Kokë), *Konomaj* (Konom), *Lazraj* (Lazër), *Lekaj* (Lekë), *Leskaj* (Lesko), *Martinaj* (Martino), *Mëhillaj* (Mëhill), *Milaj* (Milo), *Nasaj*, *Petraj* (Petro), *Qendraj* (Qendro), *Rexhaj* (Rexho), *Rucaj* (Ruci), *Zendelaj* (Zendel), *Varfaj* (Varf), *Veizaj* (Veiz) etj. dhe më pak nga patronime-kompozita, si: *Gjikokaj*, *Kokaveshaj*, *Strakoshaj*, *Stramarkaj*. Kjo prapashtesë e vjetër e shqipes formon emra fisesh a çetash<sup>21</sup> me kuptimin “i fisit të..., i vëllazërisë së...”, me funksion të njëjtë me prapashtesat *-son/-sen* të gjuhëve gjermanike apo *-viç* të gjuhëve sllave. Ajo është prapashtesa më prodhuese dhe më vepruese, pasi mund t’u shtohet të gjitha patronimeve të Himarës, të cilat mund të përdoren si me të, edhe pa të.

Ndër prapashtesat e tjera shqipe, më prodhuese janë *-an(i)*, *-uc(i)* dhe *-ush(i)*. Me prapashtesën *-an(i)* kemi patronimet *Bollano/Bullano*, *Kajani*, *Kaçelano*, *Kocano* e *Kicani*; me formantin *-uc(i)* janë formuar emrat *Dhimuci*, *Gjinuci*, *Kabuci* e *Laluci*; kurse me *-ush(i)* janë formuar patronimet *Barushi*, *Bilushi*, *Janushi*, *Tanushi*, *Kallushi* dhe *Mitrushi*.

Por pjesa më e madhe e prapashtesave shqipe që hasen në patroniminë e kësaj treve nuk janë prodhuese. Kështu, me prapashtesën *-aç(i)* kemi patronimet Makoçi e Maraçi; me *-al(i)* kemi vetëm patronimin *Muçali/Buçali*; me *-ar(i)* kemi *Boshari*; me *-ec(i)* kemi *Goreci*; me *-el(i)* kemi *Xhuveli* e *Guveli*; me *-ishtë* është formuar *Kordhishta*; me *-ko* kemi *Muçko*, *Menko* e *Meniko*; me *-osh(i)* kemi *Palloshi*, me *-ul(i)* është formuar *Kristuli*, *Gjinuli* e *Kuçuli*; me *-ull(a)* kemi patronimin *Kutulla*; me *-uq(i)* kemi patronimin *Gërdhuqi* (gardh); dhe me *-ur(i)* kemi emrat e familjeve *Kokuri* e *Konduri*.

Prapashtesat e huaja nuk janë prodhuese. Kështu, me prapashtesën greke *-adhi* kemi patronimet *Fotiadhi* e *Iliadhi*; me *-ella* kemi patronimet *Karavella* e *Xhavella*; me *-opulli* kemi *Gjikopulli*. Nga prapashtesat e tjera të huaja, me formantin *-llar(i)* janë formuar patronimet *Hitollari* e *Nikollari/ Nikollori*; me *-xhi* *Kallanxhi*; dhe me formantin *-ino* kemi *Kapino* e *Kulino*. Tek *Davidhi* e *Dividhi*, që janë e njëjta gjë, *-idh(i)* është fundore që përputhet me prapashtesën greke *-idhi*, e cila në treva të tjera ka dhënë emra familjesh, si *Avramidhi*, *Qirinxidhi* etj., por në Himarë nuk kemi gjetur patronime të formuara me të.

5. Një grup tjetër emrash të familjeve e përbëjnë patronimet-kompozita. Onomastika e fshatrave dygjuhëse të Himarës është e pasur me njësi të tilla që dalin në një numër jo të vogël qysh në regjistrin e vitit 1583, në të cilin gjejmë *Dermali*, *Gjipali*, *Gjiraçe*, *Gjomija*, *Gjinok*, *Kodheli*, *Lumadhi* e *Memlima* (?), gjë që do të thotë se kjo gjedhe e formimit të patronimeve ka qenë qysh herët tepër prodhuese e vepruese. Më 1791, numri i patronimeve-kompozita të të tri fshatrave është edhe më i madh: *Dhimaleksi*, *Dhimëdedi/Dhimodedi*, *Dhimistamo*, *Dhimokallojeri*, *Gjikhila*, *Gjikoçi*, *Gjonushi*, *Hilgjoka*, *Hilzakna*, *Kokaleksi*, *Kokëveshi*, *Kondaleksi*, *Petrogjini*, *Polimergjika*, *Qesargjika*, *Stragjini*, *Xhovasi* e *Zaknagjika*. Kurse në ditët tona patronimet-kompozita të të gjithë trevës përfshijnë disa dhjetëra njësi, inventari i plotë i të cilave mund të shihet në listën që shoqëron punimin.

Studimi i këtyre patronimeve është me shumë interes për historinë e gjuhës shqipe, sidomos i më të vjetrave ndër to, pasi gjedhja e tyre e formimit dëshmon për vjetërsinë e kompozimit si mënyrë fjalëformimi e shqipes. Veç kësaj, ato përmbajnë ndryshime fonetike që nuk dokumentohen me shkrim dhe, si të tilla, kanë vlerë të paçmuar jo vetëm për historinë e gjuhës në përgjithësi, po edhe për historinë dialektore. Studimi i këtyre kompozitave patronimike ka rëndësi edhe për historinë e fshatrave dygjuhëse dhe të gjithë krahinës së

<sup>21</sup> A. Xhuvani, E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, në: A. Xhuvani, “Vepra”, I, Tiranë, 1980, f. 429.

Himarës për të hetuar gjërat e përbashkëta që ka kjo në gjuhë e në besim me pjesën tjetër të Labërisë.

Kështu, megjithëse si rrjedhim i islamizimit antroponimia e Labërisë së brendshme ka pësuar ndryshime të mëdha, fondi i vjetër i emrave vetjakë është ruajtur gati i plotë në toponiminë dhe pjesërisht në llagapet e sotme të kësaj treve. Në të gjitha fshatrat e krahinës gjenden me shumicë mbiemra familjesh të formuar nga bashkimi i një emri të përveçëm me emrin e atit apo me një llagap, kurse shumë prej atyre që janë bjerrë si patronime ruhen në toponiminë e Labërisë. Për të krijuar një ide më të qartë për këtë, le të përqasim njësi të tilla të Kuçit të Tërbaçit dhe të Velçës, që janë fshatra të Labërisë prapa Maleve të Vetëtimës, dhe të Himarës, Dhërmiut, Palasës e Qeparoit, fshat shqipfolës i Bregut.

Kuç: *Gjokoni, Gjoklagji, Gjoveshi, Duksholla, Njonjreçi* (<Gjon Reçi), *Zakonika, Gjiguma, Gjihila, Gjikota, Gjimuçi, Gjipali, Gjiodhri, Gjodhima, Gjohelmi, Gjokbardhi, Gjokndrere, Gjomita, Gjomreshka* (<Gjon Breshka), *Gjomolla, Gjipllumi, Lagjinreu, Gjokgjine, Krismokoqurku* (Krismo Kolë Qurku), *Gjologajaj* etj.

Tërbaç: *Gjinakriqi, Haskogjin, Palipjeshka, Gjokëndi, Hilalieja, Sinogjone, Kongjeçi, Gjikalai, Zhukdashi, Kozhupaj, Babnevro, Gjibrati, Marmadhja, Gjikramo, Gjelekbosh, Gjidede, Bragjinaj, Muçodukë, Komitër, Kontava, Sinovakë, Gjomiha, Palgjone* etj.

Velçë: *Dedebrat, Dedetrush, Dhimodede, Gjivele, Gjikërrut, Gjoshogë, Hasomat, Hitomeme, Lekonde, Kokëbeshi, Kushtëgjin, Matoruk, Musavarfe, Nikëçele, Sinolik* etj.<sup>22</sup>

Himarë: *Dhimaleksi, Dhimroku, Gjinlula, Gjinuçi, Gjipeci, Gjobashi, Gjodedas, Gjojashe, Gjolulaj, Gjondhimitri, Gjovarfi, Gjovlashi, Likoka* etj.

Dhërmi: *Cukënidha, Dukshoku, Dukxhema, Gjikandrucaj, Gjikededa, Gjiguria, Gjileka, Gjinoci, Gjinocura, Gjondushi, Gjothajka, Kolgioni, Kotava, Lekdushi* etj.

Palasë: *Çaçgjoka, Dhikura, Gjondeda, Gjonkali, Nikdeda, Stratbilla* etj.

Qeparo: *Alivarfe, Bragjinaj, Dedekushtë, Gjikebitaj, Gjipogdani, Gjivlashi, Gjodhima, Gjokëpjetri, Gjomarkaj, Gjovasiaj, Kopali, Kozhupë, Lekëkond, Mërtirlagji, Magjoqurkë* (Marë Gjon Qurk), *Mbigjokondaj, Nikëdede, Nikëgjin, Protopapë, Thanasmataj* etj.<sup>23</sup>

Siç shihet, me përjashtim të dendurisë së përdorimit të temave të këtyre përbërjeve, asnjë ndryshim tjetër nuk vërehet në toponimet kompozita të fshatrave të mësipërme. Inventari i emrave të përveçëm është tepër i ngjashëm, aq sa, po të mos dish fshatin, nuk mund ta përcaktosh përkatësinë e tyre. Edhe nga struktura ato janë të njëjta. Me ndonjë përjashtim të rrallë, ato përbëhen prej dy temash, nga të cilat e para është emër vetjak, kurse e dyta emri i atit ose mbiemri i familjes. Kjo ngjashmëri e madhe në inventarin e përbërësve, në strukturën e kompozitave dhe në ndryshimet fonetike që kanë pësuar nuk mund të mos shërbejë si një dëshmi e pakundërshtueshme e njësisë së fshatrave dygjuhëse me fshatrat njëgjuhëse të Himarës dhe e kësaj krahine me pjesën tjetër të Labërisë.

6. Të ngjashëm me emrat vetjakë dypjesësh, patronimi i të cilëve është një fjalë e përbërë, janë edhe emrat vetjakë tripjesësh. Këta janë formuar nga shoqërimi i emrit të përveçëm vetjak me emrin e atit dhe të gjyshit ose të familjes, pra të ndërtuar sipas formulës: emri vetjak + emri i babait + emri i gjyshit/ i familjes. Nga pikëpamja e strukturës, njësi të tilla nuk janë bashkime lineare të tipit A + B + C, siç mund të pandehet, po ndërtime hierarkike, të tipit emër vetjak i personit plus sintagmë prej dy emrash të përveçëm, d.m.th. të tipit A + (B + C).

<sup>22</sup> L. D. Nuraj, *Velça*, Tiranë 2003, f. 40-249.

<sup>23</sup> Materialet për Tërbaçin dhe pjesërisht për Kuçin janë marrë nga arkivi vetjak i autorit. Për Himarën, Dhërmiun dhe Palasën shih B. Dollma, gazeta "Republika", 22-23 tetor 2003; një pjesë të materialeve për këto tri fshatra pati mirësinë të na i jepte z. Bardhosh Gaçe; për Qeparoin shih N. Sotiri, *E folmja dhe toponimet e Qeparoit*, Tiranë, 2001.

Në fshatrat e Himarës, ashtu si në tërë Labërinë, emërtimet tripjesëshe të personave janë të shpeshta. Emra të tillë dëshmojnë që në fillimet e pushtimit osman. Kështu, në Vuno kemi *Pilo Kasneci* (1436–1519), por i biri quhet *Kokë Pilo Kasneci* (1476–1556) dhe nipi *Pilo Kokë Kasneci* (1508–1594). Nga folklori i vjetër i krahinës vijnë emërtime të tjera: *Foto Sotir Kosta*, *Jorgo Stefan Pepe*, *Kostë Ndruco Butaj*, *Pilo Llambro Varfi*, *Spiro Gjike Qeparoi*, *Vasil Kristo Gurra*, *Vasil Pilo Bitumi*, *Zaho Jorgo Kasneci*<sup>24</sup>.

Me interes për t'u ndalur janë emrat tripjesësh të regjistrit të vitit 1583, si: *Bardho Ali Kopalli*, *Dhima Gjon Meshi*, *Dhimo Gjin Dhima*, *Dhimo Gjon Vllasi*, *Gjin Gjon Aleksi*, *Gjok Gjin Petri*, *Gjon Pavllari Mëhilli*, *Nikolla Gjin Miri* e *Todor Gjin Gjoni* në Himarë dhe *Miro Petro Kasto* e *Kondi Kosta Nasto* në Palasë. Ajo që na shtyn të priremi nga mendimi se në këto raste kemi të bëjmë me një sintagmë tripjesëshe të formuar nga bashkimi i emrit vetjak me emrin e babait dhe emrin e gjyshit, është jo vetëm mënyra se si janë shkruar këta emra, po edhe trajtat e tyre të plota, pa ndryshime apo reduktime tingujsh tek asnjëri prej elementeve. Në këtë regjistër ka edhe mjaft patronime të tjera dypjesëshe, që grafikisht ndryshojnë prej emrave të mësipërm, pasi përbërësit e tyre janë shkruar bashkë, si: *Gjipali*, *Gjiraçe*, *Gjomija*, *Gjinok*, *Kodheli*, *Lumadhi* etj. Por, i marrë në vetvete, shkrimi ngjitur i përbërësve të këtyre emrave nuk shërben si provë që kemi të bëjmë me patronime kompozita. Ajo që na bind se në këto raste kemi të bëjmë me kompozita, është forma fonetike e reduktuar e përbërësve të emrave të fundit: *Gjipali* (<Gjin Pali), *Gjiraçe* (<Gjin Raçe), *Gjomija* (<Gjon Miha), *Gjinok* (<Gjin Nok), *Kodheli* (<Kol Dheli), *Lumadhi* (Lumë Madhi). Kjo do të thotë se nuk kemi të bëjmë më luhatje të regjistruarit në shkrimin e këtyre emrave; në të vërtetë, shkruesi ka pasqyruar procese gjuhësore të cilat kishin përfunduar në kohën kur u krye regjistrimi.

Nga numri i morfemave që përmbajnë sintagmat emër vetjak plus një patronim-kompozitë mund të ngatërrohen me emrat tripjesësh. Madje, edhe E. Çabej përmend si të tillë emrat *Rustem Gjonedaj*, *Isa Gjonzeneli*, *Mitat Gjolligu*, *Myslim Gjoleka* etj.<sup>25</sup> Vërtet që këto sintagma kanë tri morfema rrënjore, por nga struktura ato janë dypjesëshe, me strukturë A + B, pasi kompozitat funksionojnë si një element i vetëm, që shënon emrin e familjes. Ato do të ishin trifjalëshe, nëse do të shtohet edhe emri i babait, pra nëse do të kishim *Myslim Zenel Gjoleka*, *Muço Sinan Leskoduka*, *Sali Sheh Alemi* etj.

Ngatërrimi me emrat tripjesësh i patronimeve dypjesëshe që kanë si përbërës të dytë një kompozitë, shpjegohet me atë që midis këtyre dy klasave nuk ka kufij të prerë, pasi patronimet-kompozita rrjedhin nga sintagma të tipit emër i babait plus emër i gjyshit a i familjes. Kjo mund të shihet tek emrat tripjesësh *Gjok Dhim Gjini*, *Gjok Gjin Petri*, *Dhimo Gjin Dhima*, *Gjin Gjon Aleksi*, *Dhima Gjon Meshi*, *Todor Gjin Gjoni* etj. të listës së vitit 1583, tek të cilët dy pjesët e fundit mund të bashkohen lehtësisht në një fjalë të përbërë: *Dhimgjini*, *Gjindhima*, *Gjingjoni*, *Gjonaleksi*, *Gjonmeshi* etj. Pavarësisht se jo në të gjitha këto raste vërtetohet bashkimi i dy elementeve të fundit, nuk ka asnjë dyshim se patronimet kompozita janë përfutur me këtë rrugë, d.m.th. me kalimin nga një sintagmë me tre përbërës në një sintagmë me dy përbërës, nga të cilët i dyti është fjalë e përbërë e përfutur nga bashkimi i dy fjalëve të fundit të sintagmës trigjymtyrëshe. Pra, kemi kalimin:

*Gjok Dhim Gjini* —> *Gjok Dhimgjini* (sot ka një familje Dhimgjini)  
*Gjin Gjon Aleksi* —> *Gjin Gjonaleksi* (nuk vërtetohet si emër familjeje)

Në onomastikën e Labërisë prapa maleve nuk janë të rralla, madje, edhe patronime trigjymtyrëshe të krijuara nga bashkimi i tre emrave të përveçëm, të cilat përdoren ende si llagape, p.sh. *Konjiveshi* [*Shako Konjiveshi* (<Kon Gjin Veshi)], *Gjozenika* [*Kadri Gjozenika*

<sup>24</sup> Nxjerrë nga tekste të këngëve të librit të F. Veizit, *Bregu i Detit në këngë*, Tiranë, 1998.

<sup>25</sup> E. Çabej, *Për gjenezën e litaraturës shqipe*, në: “Studime gjuhësore”, V, Prishtinë, 1975, f. 124.

(<Gjon Zef Nika)], por më shumë si toponime: *Dedegjivesh* (Dede Gjin Vesh), *Gjoniklagji* (Gjon Nik Lagji), *Konjillesh* (Kon Gjin Lleshi) etj.

Emra të përveçëm me patronime kompozita apo emra tripjesësh dhe me të njëjtët përbërës si këto të Himarës dhe të Labërisë prapa maleve gjenden edhe në treva veriore të vendit, si p.sh. Ilagapet (Dedë) Gjolluli, (Gjon) Markagjoni, (Lekë) Dukagjini apo emrat trifjalësh nga folklori, si Gjergj Elez Alija, Gjeto Basho Muji etj. dhe historikë, si Gjergj Stres Balsha, Preng Bib Doda etj. Ka pasur përpjekje për ta shpjeguar këtë ngjashmëri me migrimin dhe vendosjen në Labëri të fiseve veriore. Kështu, sipas Gj. Sheldisë, Kurveleshi e ka prejardhjen prej Kelmendit a Malësisë së Madhe, kurse shumë shtëpi të Himarës «janë të ardhur prej Krujet, kur përcollnë Gjonin II Skënderbe, atëherë kur mori mërgimin për n'Itali»<sup>26</sup>.

Ky pohim vlen vetëm pjesërisht për Himarën, ku dihet se lagjja Gjilekë e Dhërmiut është vërtet me prejardhje nga Kruja. Por përkimet në onomastikën e Himarës dhe të Labërisë me atë të trevave veriore nuk mund të shpjegohen me shtegtimin në Jug të fiseve të Veriut. Megjithëse lëvizjet e popullsisë brenda vendit janë një dukuri e natyrshme, nuk ka dëshmi dhe as mund të mendohet që një krahinë e tërë të jetë e ardhur prej veriut të vendit.

Argumentet për karakterin vendës të labëve të Himarës dhe të Labërisë pas maleve janë të shumta. Si argument kryesor në mbështetje të mendimit se popullsia e Labërisë nuk është e ardhur shërbejnë veçoritë e labërishtes dhe vendi i saj në ndarjen dialektore të shqipës. E folmja e Labërisë, si një e folme periferike e shqipës dhe, për pasojë, më konservatore se të folmet qendrore, ka ruajtur në sistemin e saj elemente të vjetra të shqipës, duke afruar në këtë pikë me disa prej të folmeve veriore që i kanë edhe ato këto elemente, gjë që e ka vënë në dukje me kohë E. Çabej. Por, me gjithë disa pika takimi me të folme gege, labërishtja është një nëndialekt i toskërishtes, me një varg tiparësh të përbashkëta me nëndialektet e tjera toske, sidomos me çamërishten.

Një argument tjetër gjuhësor për karakterin anas të popullsisë së Labërisë përbën edhe natyra e ndryshimeve fonetike që kanë pësuar patronimet dhe toponimet e kësaj treve. Ndër dukuritë fonetike karakteristike që vërehen në patronimet dhe toponimet e kësaj treve janë kthimi i një *n*-je midis zanoresh në *r* dhe reduktimi i zanoreve *a* ose *o* në *ë*, si p.sh. *Mërtir* (<Martin), *Lazër* (Lazar), *Todhër* (<Todor) etj.; përngjashmimet dhe rëniet e tingujve bashkëtingëllorë në kufijtë e temave, si në rastet: *Gjileka* (Gjin Leka), *Gjimuçi* (Gjin Muçi), *Gjomolla* (Gjon Molla), *Koprifti* (Kolë Prifti), *Likoka* (Lik Koka) etj. Këto ndryshime shpjegohen me rregulla të fonetikës historike të toskërishtes, gjë që do të thotë se janë përfutur në truallin e Labërisë. Për sa i përket moshës së tyre, dihet se një dukuri e tillë tipike e të folmeve toske si rotacizmi ka pushuar së vepruari aty nga shekujt VII–VIII, para depërtimit të huazimeve sllave në shqipe<sup>27</sup>. Edhe kthimi i zanoreve *a* dhe *o* në *ë*, përngjashmimet dhe rëniet e bashkëtingëlloreve fundore apo në kufij temash janë shkaktuar nga rregulla fonetike që kanë pushuar së vepruari qysh herët, përdërisa dukuri të tilla i gjejmë edhe në patronimet e vitit 1583, në mos edhe më përpara. Një dukuri tjetër tipike për toskërishten është prapavendosja e pjesëzës pasthirmore *o* tek emrat, që është shumë e përhapur në emrat e përveçëm. Të tillë emra si *Bardho*, *Dhimo*, *Dhjako*, *Çaço*, *Marko*, *Pano*, *Petro* etj., që janë të shpeshtë qysh në regjistrin e vitit 1583, qoftë si emra vetjakë qoftë si emra familjesh, mungojnë në gegërishte. Prapavendosja e kësaj pjesëze, siç shihet nga shembujt e mësipërm, është një dukuri relativisht e vjetër e toskërishtes. Ndonëse mungesa e dëshmimeve të shkruara nuk na lejon ta përcaktojmë me saktësi kohën e shfaqjes së saj, numri i madh i emrave me këtë fundore më 1583 mund të merret si një dëshmi se kemi të bëjmë me një dukuri të ngulitur në këto treva shekuj më parë.

<sup>26</sup> Gj. Kola, *Himara*, Revista “Hylli i Dritës”, 1939, f. 417 (Gjeto Kola është pseudonim i Gjush Sheldisë).

<sup>27</sup> Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 56.

Këto ngjashmëri në onomastikën e Labërisë me atë të Veriut të Shqipërisë gjuhëtarët dhe historianët i shohin si një ndër dëshmitë më të forta të prejardhjes së përbashkët dhe të njësisë etnike të shqiptarëve. Kështu, E. Çabej, duke u ndalur tek emrat tripjesësh të personave ka vënë në dukje se këta i kanë së bashku si Veriu dhe Jugu i Shqipërisë. Si shkak kryesor të këtyre përkimeve ai pranon një faktor të brendshëm, «një element konservues i vendit vetë, i pamvarur nga shtegtimet: thelbi i thjeshtë i shqiptarizmit të moçëm, i cili në Shqipërinë e Mesme u zhduk, në malet anësore të Veriut e të Jugut i mbeti besnik vetvetes»<sup>28</sup>. Pra, ai i sheh këto përkime si «gjurma të lashta të njësisë së dikurshme shqiptare», që «kanë mbirë pa dyshim te ky truall dhe shpjegon me rëndësinë që i jep shqiptari ruajtjes së fisit të vet edhe me emër.»<sup>29</sup> Duke iu rikthyer sërish kësaj kategorie emrash vetjakë vite më vonë, Çabej ka theksuar rëndësinë që kanë këta për të provuar njësinë e popullit tonë. Sipas tij, «parimi i paraqitjes së këtyre emrave me këto pjesë është interesant: në popujt e tjerë të Ballkanit, nga sa di unë, me përjashtim të disa emrave bizantinë, nuk del një gjë e tillë; është pra mjaft specifike për popullin tonë»<sup>30</sup>.

7. Në patroniminë e Himarës dëshmojnë një varg dukurish gramatikore e fonetike që paraqesin interes të veçantë për t'u hetuar e diskutuar. Disa prej tyre janë të mbarë shqipes, disa të mbarë toskërishtes, por ka edhe dukuri tipike për këtë trevë, që e dallojnë nga pjesa tjetër e Labërisë.

Për t'u shënuar është se, për sa u përket fundoreve, të gjitha patronimet shqipe të Himarës dalin më zanore ose më *-j*. Me fundore më një bashkëtingëllore dalin vetëm patronimet e huaja, si *Averbak*, ose ato që kohët e fundit vetë bartësit e tyre i kanë greqizuar, si *Haxhanis* e *Dounis*. Në pozicion fundor dalin të gjitha zanoret, me përjashtim të zanores *ë* dhe të zanores *y*, e cila mungon në sistemin fonetik të kësaj së folmeje. Nga këto, zanoret *e* dhe *o*, janë fundore të temave, kurse të tjerat konsiderohen përgjithësisht si nyja. Si rrjedhim, në patronimet e Himarës mund të dallohen dy grupe: një grup që dalin në trajtë të pashquar, ku hyjnë emrat me *-e*, *-o* dhe me *-aj*, dhe grupi tjetër, më i madh në numër, i cili përfshin emrat që dalin me zanoret *-a*, *-i* dhe *-u* të cilat shërbejnë si nyja shquese. Por meqenëse patronimet janë vetvetiu të caktuar dhe «prania apo mungesa e nyjës shquese pranë një emri vetjak është një gjë krejt formale»<sup>31</sup>, si nyja këto formante janë mjete redondante. Meqë nga pikëpamja e individualizimit emrat e përveçëm, përfshirë këtu edhe emrat e familjeve, janë të caktuar dhe prania e formantit ka karakter teprues, te patronimet nyjat kanë marrë një funksion fjalëformues. Që nyjat e prapme te patronimet janë më fort mjete fjalëformuese se trajtëformuese, kjo duket nga ajo që këto nyja mund të alternohen midis tyre ose edhe me zanoret *e* dhe *o*, si dhe me prapashtesën *-aj*. Një argument tjetër në mbështetje të këtij mendimi është edhe pamundësia e përdorimit në trajtë të pashquar të patronimeve me *-i*, *-u* dhe *-a*, ndërkohë që ata me fundoret *-e*, *-o* dhe me prapashtesën *-aj* mund të përdoren. Kështu, themi *Apostol Kumi* por jo *Apostol Kum*, *Spiro Qesku* por jo *Spiro Qesk*, *Jani Kashta* por jo *Jani Kashtë*, *Maria Papa* por jo *Maria Papë*, *Grigor Leka* por jo *Grigor Lekë* etj., ndërkohë që kemi *Ilia Babe* por edhe *Ilia Babja*, *Thoma Grillo* dhe *Thoma Grillua/Grilloja*, *Niko Petraj* por *Petrajt* (si familje). Kjo do të thotë që *-i*, *-u* dhe *-a* te këta emra nuk duhen parë si nyja shquese, por si formante të një lloji të veçantë që i kanë ngurtësuar temat morfologjike të fjalëve të cilave u janë shtuar, duke i kthyer format e përfutuara në patronime.

<sup>28</sup> E. Çabej, *Për gjenezën e litaraturës shqipe*, në: “Studime gjuhësore”, V, Prishtinë, 1975, f. 113.

<sup>29</sup> *Po aty*, f. 124–125.

<sup>30</sup> Po ai, *Diskutim rreth kumtesave të K. Trajmerit, H. Buasenit dhe S. Manit*, “Studime gjuhësore”, V, f. 239.

<sup>31</sup> Ç. Bidollari, *Emri i përveçëm vetjak...*, art. i cit., f. 151.

Për sa i përket alternimit të këtyre fundoreve, në patronimet e Himarës vërehen disa rregullsi, që herë janë të natyrës semantike e herë fonetike. Kështu, zanorja fundore *-a* mund të alternohet me fundoret *-o*, *-e*, *-i* dhe me *-aj*, por jo me fundoren *-u*, pasi ky formant ka kushtëzim fonetik; fundorja *-u* mund të alternohet me fundoren *-o* ose me prapashtesën *-aj*: *Kreku* dhe *Kreka*, por mundet edhe *Krekaj*. Formanti *-i* alternohet me fundoret *-a*, *-e*, *-o*, *-u* dhe *-aj*, por me kufizimin semantik që nuk mund të këmbëhet me fundoren *-a* të patronimeve prej emrash femërorë të tipit *papë* apo mashkullorë të tipit *Lekë*. Kështu, kemi *Baba* dhe *Babe*, *Basha* dhe *Bashi*, *Bollano* dhe *Bollana*, *Cani* dhe *Cane*, *Cura* dhe *Curi*, *Dedi* dhe *Dede*, *Dhimuci* dhe *Dhimuco*; *Dhrami*, *Dhrama* e *Dhramaj*, *Duka* dhe *Dumo*; *Gjidede* dhe *Gjodedo*, *Gjikopulli* dhe *Gjikopullo*, *Hiso* dhe *Hisa*, *Karavella* dhe *Karavello*, *Lapa* dhe *Lape*, *Mali* dhe *Malo*, *Mato* dhe *Mata*, *Mile* dhe *Milo*, *Naçi* dhe *Naço*, *Nina* dhe *Nini*, *Nota*, *Noti* dhe *Note*, *Pani* dhe *Pano*, *Pula* dhe *Pulo*, *Qesku* dhe *Qesko*, *Sheti* dhe *Sheto*, *Stefa* dhe *Stefo*, *Strakosha* dhe *Strakosho*, *Tata* dhe *Tato*; por *Papa* dhe jo *Papi*, *Leka* dhe jo *Leki* etj.

Te kompozitat, si rregull ruhet nyja e temës së dytë, ndonëse ka edhe ndonjë përjashtim, si: *Gjidedo* e *Gjideda*, *Strakosha* e *Strakosho*.

Siç mund të shihet edhe nga shembujt e sjellë deri tani, ndër formantet më prodhuese janë *-o* dhe *-aj*: çdo formant tjetër mund të ndërkeqmbëhet me lehtësi me këto dy elemente. Megjithatë, prapashtesa *-aj* nuk është aq prodhuese në Himarë sa në pjesën tjetër të Labërisë, ku formimet me të janë të shumta. Ky ndryshim në produktivitetin e këtij formanti në të dy anët e Labërisë duket qartë kur krahasohen patronime të njëjta të familjeve himarjote me ato të familjeve labe të vendosura në Himarë pas mesit të shekullit të kaluar. P.sh., familjet vendëse mbajnë emrat: *Bala*, *Cani*, *Dedi*, *Kongjini*, *Lami*, *Leka*, *Mëhilli*, *Qendri*, *Shkurti*, *Stefani* etj., kurse emrat gjegjës të familjeve ardhëse mbarojnë me-(a)j: *Balaj*, *Canaj*, *Dedaj*, *Kongjinaj*, *Lamaj*, *Lekaj*, *Mëhillaj*, *Qendraj*, *Shkurtaj*, *Stefanaj* etj.

Një dallim tjetër midis këtyre dy trevave në funksionin e kësaj prapashtese, është se në Himarë ajo shërben si një mjet hiperkarakterizues, pasi patronimet e formuara me të kanë edhe një trajtë tjetër pa këtë prapashtesë, si p.sh. *Lekaj* e *Leka*, *Martinaj* e *Martino*, *Petraj* e *Petro*, *Karaj* e *Karo*, *Shetaj* e *Sheti* etj. Karakteri teprues i saj duket sidomos në patronime të formuara me prapashtesa, si p.sh. *Andrucaj*, *Kocanaj*, *Kuçulaj* etj., të cilat shërbejnë si të tilla edhe pa të. Kurse në rastet kur u shtohet patronimeve prej temash joshqipe apo me prapashtesa të huaja, kjo prapashtesë ka edhe një funksion tjetër. Ajo i bën këto patronime të ndihen si shqipe, d.m.th. të kenë një formë të ndryshme dhe të tingëllojnë ndryshe nga ç' do të tingëllojnë në bashkësi joshqipfolëse.

Edhe fundorja *-i* është një tjetër formant me të cilin ndërkeqmbëhen lehtë formantet e tjera, veç *-u-së*. Këto ndërkeqmbime ndodhin edhe me fundoret e temës së parë të kompozitave, si në rastet *Kokodhima* për *Kokëdhima*, *Dhimistamo* për *Dhimëstamo*, *Dhimigjoka* për *Dhimëgjoka*. Kjo bën që patronimet e Himarës të mos dalin me një, po me disa forma, gjë që krijon vështirësi për administratën, sidomos në kushtet kur nuk ka rregulla të rrepta për shkrimin e patronimeve, siç do të kërkohej në një sistem anagrafik të kompjuterizuar.

Kohët e fundit në Himarë, sidomos në fshatrat greqishtfolëse të saj, nën ndikimin e faktorëve ekonomikë e politikë, po vërehet prirja për riinterpretimin e patronimeve, duke synuar modernizimin dhe, në disa raste, edhe tëhuajëzimin e tyre. P.sh., në vend të patronimit tradicional *Nerënxi*, në regjistrin e zgjedhjeve kemi individë me llagapet *Neranxhi*, *Neranxini*, *Neraxi*, *Nerenxi* e *Nerexi*; krahas *Mile*, në këtë regjistër gjejmë *Mila* dhe *Millios*; krahas *Mëhilli*, gjejmë *Mhi* e *Mihilli*; krahas *Gjikopulli*, *Bollano* e *Çakalli* gjejmë përkatësisht *Gjikopollo*, *Bolano* e *Çakali*. Disa patronimeve u është ndërruar edhe forma, duke përfunduar në greke, si: *Dounis*, *Haxhanis* e *Triandafillu*.

8. Nga materiali i analizuar deri tani del se patronimet e himarjotëve janë pjesë e fondit patronimik shqiptar, si në pikëpamje të inventarit, edhe në pikëpamje të rrugëve të krijimit të

tyre, edhe nga pikëpamja e veçorive gjuhësore që paraqesin. Kur i vihesh shqyrtimit të këtij fondi, gjëja e parë që të bie në sy është vjetërsia e një pjese të mirë të tij dhe ruajtja pothuajse e paprekur e inventarit të hershëm. Emrat e familjeve, ndryshe nga emrat e vetjakë, ndikohen më pak nga moda. Kjo është edhe më e vërtetë për trevën e Himarës, e cila për vetë historinë e saj është një krahinë që është prekur më pak nga ndryshimet politike dhe fetare. Si rrjedhim, Himara dallon nga pjesa tjetër e Labërisë, madje edhe nga zonat malore të saj, që shquhen për ruajtjen e traditës, pasi është një ndër trevat shqiptare ku janë ruajtur më mirë elementet e kulturës së lashtë iliro-arbëreshe. Ky pohim ka vlerë sidomos për patroniminë, si fushë e gjuhës që është më pak e prirur për ndryshime në krahasim me fushat e tjera.

Këtë lashtësi të thesarit patronimik të Himarës e dëshmojnë emrat e familjeve që vijnë nga emra të tillë, si *Lekë, Piro, Qezar, Likë, Damo* etj., të trashëguar prej lashtësisë iliro-maqedono-epirote; patronimet nga emrat e lashtë të botës pagane ilire, si *Zot, Premt, Martë* etj.; patronimet që rrjedhin nga emra të krishterimit të hershëm, si *Pal, Gjon, Gjin, Gjergj, Lazër, Todhër, Gjokë, Gjikë, Mëhill, Mitër, Ndre* etj.

Konservacioni që e shquan onomastikën e Himarës në përgjithësi, duket veçanërisht qartë në patroniminë e saj. Krahinat e Labërisë prapa maleve ruajnë vetëm një pjesë të vogël të fondit të vjetër patronimik si llagape, pasi pas islamizimit është nxjerrë jashtë përdorimit shumica e tyre, duke u zëvendësuar me emra myslimanë të botës turko-arabe, kurse pjesën më të mirë të këtij fondi e ruajnë në toponimi. Ndërsa krahina e Himarës, falë mbajtjes së besimit të krishterë, fondin e vjetër patronimik e ka ruajtur të plotë edhe në emrat e familjeve, edhe në toponiminë e saj, e cila, falë ruajtjes së patronimeve të vjetra, nuk ka këtu atë rëndësi si në pjesën tjetër të Labërisë. Toponimia e saj merr një vlerë të posaçme në rastin e emërtimeve gjeografike prej emrash të përveçëm vetjakë dhe emrash të familjeve që sot janë larguar nga Himara ose janë shuar, si: sheshi i *Marulit*, (varret) e *Marulëve, Komn* (fis), *Mara* (fis), *Matërënga, Muzaka* (tokë), *Nikogjan, Pagnatatë, Protopapë, Qaf* e *Skurës, Thopaj* (fis) etj. Vlera e këtyre toponimeve qëndron në atë që, duke u mbështetur në to, mund të gjykojmë për përkatësinë etnike të bartësve të këtyre emrave dhe, në këtë mënyrë, t'i jepet një përgjigje bindëse pyetjes se ç'janë himarjotët.

Ajo që na bën të themi se fondi patronimik i Himarës është shqiptar, madje shumë më tepër se ai i Labërisë së brendshme, është jo vetëm inventari pothuajse tërësisht shqip, po edhe gjedhet e ndërtimeve dhe mjetet e përdorura për krijimin dhe pasurimin e këtij inventari. Një shenjë e karakterit autokton të këtij fondi janë emrat vendës, për të cilët sapo u fol. Jo vetëm patronimet dhe toponimet kompozita, emërtimet dypjesëshe e tripjesëshe, por edhe shumica e emrave të përveçëm dhe toponimet prej emrash vetjakë të Himarës hasen gjithandej në Shqipëri, gjë që dëshmon për autoktoninë e banorëve të këtyre fshatrave.

Edhe formantet fjalëformuese të patronimeve janë gjithashtu anase. Siç u pa më sipër, numri i prapashtesave të huaja është shumë i vogël në krahasim me prapashtesat shqipe dhe, për më tepër, këto prapashtesa të huaja nuk janë as prodhuese dhe as vepruese. Një provë tjetër e karakterit anas të këtij fondi janë gjedhet fjalëformuese, të cilat janë tipike për shqipen, si në rastet e prejardhjes me prapashtesa, edhe në rastin e përbërjeve.

Më në fund, gjithë leksiku patronimik, duke u trashëguar nga brezi në brez, u është nënshtruar rregullave fonetike të shqipes, të cilat kanë dhënë trajta që nuk mund të ishin të tilla, nëse nuk do të kishin kaluar në gojën e shqipfolësve.

## PATRONIMET E HIMARËS

### Emrat e familjeve të Himarës, Palasës dhe të Dhërmiut (1583)

*Adeti?* (Manush), *Ajas* (Andon), *Aleksi* (Papa), *Alemdari* (Gjok), *Ali Kopalli?* (Bardho), *Andoni* (Andrea), *Andrea* (Dhimo), *Andrea* (Jorgo), *Andrea* (Kond), *Andrea* (Todor), *Andredo?* (Kont), *Bardhi* (...), *Bero* (...), *Bero* (Mano), *Boga* (Gjoka), *Bojko* (Dhimo), *Bojko* (Todor), *Buçali?*/Bukali?/Muçali? (Gjin), *Bukali?*/Buçali?/Muçali? (Kondi), *Çaço/Caco?* (Andrea), *Damiani* (Qezar), *Damo* (Vaso), *Deda* (Dhimo), *Deda* (Kondi), *Demi?*/Remi? (Gjin), *Demka* (Zot), *Dermali* (Dhimo), *Dermali* (Leka), *Dimitrie* (Dëmbllar?), *Dumani* (Andrea), *Dhamo* (Dhimo), *Dhamo* (Gjoka), *Dhim Gjini* (Gjok), *Dhima* (Balsh), *Dhima* (Gjika), *Dhima* (Gjin), *Dhima* (Kondi), *Dhima* (Nika), *Dhima* (Petri), *Dhima* (Petri), *Dhimaqi* (Paskal), *Dhimja* (Vaso), *Dhimo* (Gjoka), *Dhimo* (Jari? Pari? Nari?), *Dhimo* (Jorgo/Bojko?), *Dhimo* (Kondi), *Dhimo* (Kristo), *Dhimo* (Lehamo), *Dhimo* (Niko), *Dhimo* (Pali), *Dhimo* (Todor), *Dhimo* (Zot), *Dhjako* (Emeklu?), *Dhjako* (Pali), *Emelkuri?* (Dhima), *Gjin Dhima* (Dhimo), *Gjin* (Gjoni), *Gjin Gjoni* (Todor), *Gjin Miri?* (Nikolla), *Gjin* (Nika), *Gjin Petri* (Gjok), *Gjini* (Gjok), *Gjini* (Leka), *Gjini* (Petri), *Gjini* (Todor), *Gjinok?* (Todor), *Gjipali/Gjikalli?* (Duman), *Gjiraçe* (Gjika), *Gjiraçe* (Gjon), *Gjomija?* (Andrea), *Gjon Aleksi* (Gjin), *Gjon Meshi* (Dhima), *Gjon Vllasi* (Dhimo), *Gjoni* (Gjika), *Gjoni* (Gjin), *Gjoni* (Kond), *Gjoni* (Mark), *Gjoni* (Martin), *Gjoni* (Menkul), *Gjoni* (Nikolla), *Gjoni* (Petri), *Gjoni* (Zot), *Gjorzaj* (Gjini), *Gjuhamoli?* (Lika), *Jak* (Vojo), *Jari?*/Pari?/Nari? (Dhimo), *Jorgji* (Dhimo), *Jorgji* (Papa), *Jorgo* (Andrea), *Jorgo* (Gjin), *Jorgo* (Gjok), *Jorgo* (Gjoka), *Jorgonllu?* (Thanas), *Kallandori* (Nika), *Kodheli* (...), *Kola* (Dedë), *Kola* (Dhrako), *Komnini* (Andrea), *Komnini* (Jorgji), *Kondavik?* (Todor), *Kondi* (Dhimo), *Kondi* (Gjin), *Kondi* (Gjurka), *Kondi* (Kosta), *Kondi* (Lika), *Kondi* (Vojo), *Kosta* (Leka), *Kosta Nasto* (Kondi), *Kosta* (Nikoll), *Kosta* (Todor), *Kristuli* (Jorgo), *Kudhës?* (Todor), *Lehamo?* (Gjon), *Lehamo?* (Thanas), *Lehkani?* (Pal), *Leka* (Dhimo), *Leka* (Gjek), *Leka* (Nika), *Lela/Della?* (Kond), *Leondari* (Gjon), *Leondari* (Kuka), *Levendari?* (Mihran?), *Lihamoqi?* (Andrea), *Lihori?* (Pali), *Lindo* (Nika), *Livrani?*/Lehrani? (Nikolla), *Lohomo?* (Gjon), *Lohomo?* (Todor), *Lumadhi* (Todor), *Llanka* (Gjik), *Llazari* (Gjika), *Madhima?* (Brumo), *Mamija* (Dhimo), *Mamija* (Meks), *Mandashi* (Dole), *Marini* (Nika), *Marko* (Dhamo), *Marko* (Nika), *Martini* (Kond), *Martini* (Nikë), *Mastro* (Dhimo), *Mastro* (Gjon), *Mavllari?* (Gjin), *Medrosi?*/Drosi? (Jorgo), *Mëhilli* (Gjika), *Mëhilli* (Todor), *Meksi* (Gjin), *Meksi* (Leondar), *Meksi* (Papa), *Meksi* (Todor), *Melani* (Pal), *Memlima?* (Jorgji), *Menika/Mnika?* (Gjon), *Menko/Nenko?* (Aleks), *Menkuli* (Andrea), *Menkuli* (Gjok), *Mërkuri* (Kondi), *Mihali* (Deliro), *Mihali* (Dhimo), *Mihali* (Gjon), *Mihali* (Petko), *Mihallo?*/Limarho? (Dhimo), *Mirdemko* (Todor), *Mirini* (Niko?), *Mitrije* (Meks), *Mnika/Menika?* (Meks), *Muja* (Dhimo), *Mujo* (Lirbo?), *Muka* (Kondaramo), *Musiça* (Andrea), *Musuni?* (Dhimo), *Nasto* (Dhimo), *Nenko?*/Petko? (Kosta), *Nika* (Dhima), *Nika*

(Gjoka), *Nika* (Leka) *Nika* (Pal), *Nika* (Simon), *Nika* (Todor), *Nikolla* (Dhimo), *Nikolla* (Papa), *Nikolla* (Qezar), *Nikolla* (Qiro), *Pali* (Gjin), *Pali* (Gjok), *Pali* (Jorgo), *Pali* (Leondar), *Pali* (Nika), *Pali* (Todor), *Pali*?/Jani? (Dhimo), *Pali*?/Jani? (Gjoka), *Palloshi* (Gjon), *Palloshi* (Meksi), *Panajoti* (Pali), *Pano* (Andorçe), *Pano* (Gjika), *Pano* (Kristok), *Panoja* (Gjon), *Panomllu* (Kond), *Panuçi* (Kond), *Papa* (Aleksi), *Papa* (Dhimo), *Papa* (Kond), *Papa* (Pali), *Paskali* (Aleks), *Paskali* (Dhimo), *Paskali* (Menko), *Paskali* (Pali), *Paskali* (Qirjako), *Pavllari Mëhilli*, (Gjon), *Peçi* (Aleks), *Pelikani* (Dhimo), *Petko* (Vaso), *Petri* (Andrea), *Petri* (Kondi), *Petri* (Petri), *Petro* (Apostol), *Petro* (Dhimo), *Petro Kasto* (Miro?/Marito?), *Petro* (Llazar), *Petro* (Papa), *Piro*?/Poros? (Gjin), *Plaku* (Nika), *Pobrat* (Dhimo), *Premti* (Kond), *Qezari* (Andrea), *Qezari* (Gjoka), *Ruqi*?/Zhuqi? (Gjin), *Sallaja* (Gjin), *Sima* (Petko), *Sinani* (Dhimo), *Sinani* (Meks), *Stavro* (Andrea), *Stimaqi*? (Todor), *Streli*? (Kondi), *Suvari*? (Mark), *Tanushi* (Dhimo), *Tanushi/Janushi*? (Martin), *Todor Brati* (Perlin?), *Todor* (Gjika), *Todor* (Leka), *Todori* (Gjik), *Todori* (Gjin), *Todori* (Kont), *Todori* (Petri), *Todori* (Zot), *Thanasi* (Miho), *Thanasi* (Nika), *Thanasi* (Papa), *Ulmi/Almi*? (Selka), *Vasili* (Andrea), *Vasili* (Dhimo), *Voja/Doja*? (Komin), *Zagori* (Todor), *Zota* (Andrea), *Zoto*, *Zoto* (Kondi), *Zylkadër* (Martin?)

### **Emra familjesh të Himarës, Dhërmiut dhe të Palasës (1791)**

Andrea, Athanasi, Biça, Biçili, Bua, Burbo, Dina, Dhimaleksi, Dhimëdedi, Dhimistamo, Dhimo/Dhima, Dhimodedi, Dhimokallojeri, Gjika, Gjikhila, Gjikoçi, Gjoka, Gjonushi, Hilgjoka, Hilzakna, Kasneci, Koka, Kokaleksi, Kokëveshi, Kondaleksi, Kosta, Kovaçi, Kulumba/Kolumba, Leka, Mantho, Meniko, Mikeli, Muçi, Nina, Norkolla, Petrogjini, Polimergjika, Polimeri, Qesargjika, Qezari, Rexho, Sazano, Spiro, Stragjini, Varfi, Vreto, Xhili, Xhorxhi, Xhovasi, Zakna, Zaknagjika.

### **Emrat e familjeve të bashkisë së Himarës (2003)**

Aleksi, Anagnosti, Andoni, Andruçi (Andruco), Apostoli, Averbak, Baba, Babe, Baka, Bala, Balla, Ballamo, Barushi, Basha, Bashi, Beja, Beleri, Beli, Belina, Beno, Beruka, Bica, Bifsha, Billa, Bilushi, Biti, Bixha, Bixhili, Boci, Bodini, Bokollo, Boli, Bollano (Bollana, Bolani), Bonjako, Boro, Boshari, Brame (Brami), Brigo, Bua, Buco, Bufi, Bulla, Bullano, Burbo, Burgo, Buta, Cani (Cane), Ckura, Cura (Curi), Çaçi, Çakalli (Çakali), Çako, Çali, Çeço, Çini, Çipa, Çomora, Çulla, Dafla, Dani, Davidhi, Dedi, Dede, Dini, Dividhi, Doko, Dounis (Duni?), Duci, Duka, Duko, Dumo, Duni, Dhima, Dhimaleksi, Dhimëgjoka (Dhimgjika, Dhimgjika), Dhimitraqi, Dhimitri, Dhimogjika, Dhimogjini, Dhimogjoka, Dhimojani, Dhimolea, Dhimuci, Dhimuco, Dhrako, Dhrama (Dhramaj), Dhrami, Fllori, Fotiadhi, Foto, Gali, Gërdhuqi, Gogo, Goreci, Goro, Grillo, Guga, Guma, Gurgura, Guri, Guveli, Gjergji, Gjezo, Gjįçali, Gjįdede (Gjįdedo), Gjika, Gjįknuri, Gjįkoka, Gjįkokaj, Gjįkondi, Gjįkopulli (Gjįkopollo, Gjįkopullo), Gjįkuria, Gjįlaçi, Gjįni, Gjįnuci, Gjįnuli, Gjįpali, Gjįzo, Gjįdede, Gjįoka, Gjįokrushi, Gjįkushi, Gjįmemo, Gjįmeni, Gjįni, Gjįora, Gjįvasho, Harito, Haxhanis, Hida, Hila, Hiso (Hisa), Hysa, Hitollari, Ilija, Iliadhi, Janaqi, Janila, Janushi, Jashi, Jeto, Jorgji, Jorjani, Joshi, Jovani, Kabuci, Kacelano, Kaçi (Kaci?), Kafilaj, Kajani, Kallanxhi, Kallushi, Kapetani, Kapino, Kapo, Karali, Karavella (Karavello), Karëzi, Karmeni, Karo, Karzi, Kashta, Katiu, Keka, Kicani, Kisi, Kocani, Koçi, Koçini (Kocini?), Kocka, Koço, Koka (Kokaj), Kokaveshi (Kohaveshi), Kokavethi?, Kokëdhima (Kokdhima, Kokodhima), Kokuri, Kola, Kolagji, Koleka, Hiso (Hisa), Kolila, Kolina, Komëhedhi, Komëhilli (Konihilli), Kondi, Kongjika, Kongjini, Konomi, Koraveshi, Kordhishta, Kosi, Kosta, Kostajani, Kote, Kreku (Kreka), Kristo, Kristofori, Kuci (Kuçi?), Kuçuli, Kuli, Kulino, Kumi, Kuri, Kushta, Kutulla, Lami, Lani, Lapa (Lape), Lati, Lazari, Leka (Lekushi), Lesko, Liati, Likaj, Likoka (Likona), Loca, Loli, Luci (Luçi), Lule, Luta, Llaguri, Llambro, Llanduri, Llazari, Lluka, Mai, Makoçi, Mali, Malo, Manoli, Maraçi, Marko,

Marku, Marta, Martino (Martina ), Mato (Mata), Mboqe, Mëhilli (Mhi, Mihilli), Mehmelli, Memi, Meniko, Mërkuri, Mërtiri (Mërtin), Merxhani, Mile (Milia, Millios), Milo, Miti, Mitrushi, Muçko, Muço (Muçua), Muso (Musua), Naçi, Naço, Nako, Nasaj, Nasho, Ndrenika, Ndreri, Neço, Nerani, Neranxi (Nerënxi: Neranxhi, Nernaxini, Neraxi, Nerenxi, Nerexi), Nesturi, Nika, Nikollori (Nikollari), Nina, Nini, Niso, Nota, Note, Noti, Nushi, Odhisea, Ormëni, Paço, Pali, Panajoti, Pando, Pani, Pano, Panoandrea, Papa, Papadhimitri, Papajorgji, Papanikolla, Papasava, Paskali, Pavli, Pavllo, Peçuli, Petraj, Petro, Petromilo, Pjero, Plaku, Polo, Prifti, Proto, Pula (Pulo, Qendri), Qesari, Qesku (Qesko), Qirici, Qirjaqi, Qirjazi, Qurku, Rando, Rapo, Rapokote, Raro, Reçi, Rexho, Rikaj, Rondo, Rucaj, Ruci, Rusha, Sava, Simo (Sima), Simoni, Skura (Zgura), Soro, Sotiri, Spiro, Spirogjika, Spiromilo, Stefa, Stefani, Stefo, Sterjo, Strakosha (Strakosho), Stramarko (Stamarko), Shanto, Sheto, Shia, Shkurti, Shuli, Tata, Tato, Todhri (Todhëri), Treko, Triandafillu, Thanasi, Thanasmati, Theodhori, Thimi, Thodhorjani, Ukoka, Varfi, Vasili, Veizi, Velço, Vello (një), Vengo, Vera, Veruari (një), Vito, Vjero, Vlashi, Vogli, Vongli, Vreto, Xani, Xhavela, Xhuveli, Zaho (Lab. Zahaj), Zbogo (Zboga), Zeno, Zi, Zoto, Zhaku, Zhamllota (Zhamllota), Zhebo, Zhupa.

## SUMMARY

### The patronymic of Himara

This study is devoted to the patronymic of the Himara region. This region is situated south of Valona, on the Western coast of the Acroceraunian mountains. It comprises the town of Himara – the center of the Himara municipality – and Palassa, Dhermi, Vuno, Pilur, Kudhes and Qeparo villages. Three of these inhabited centers, namely Himara, Dhermi and Palassa, are bilingual in Albanian and Greek, four others are monolingual in Albanian.

According to the Greek propaganda, a Greek minority inhabits the region of Himara. The aim of the author is to shed light on their ethnicity through an analysis as thorough as possible of the family names of the inhabitants of this region. In order to do this, family names of three different periods of time are taken into consideration: first, proper and family names of three Greek-speaking villages of this region, according to the Ottoman register of 1583 of the Delvina sandjak; family names from the three bilingual villages found in a list of the year 1791; and lastly family names taken from the lists of voters of the Himara region for the local elections of October 2003.

The onomastics is one of the most conservative parts of the inheritance of an ethnicity, and as such it is invaluable for the history of any ethnic group. This is true especially for this region, which has preserved its Christian religion unchanged through centuries.

From the analysis of the data of the three periods it results that not only the patronymic, but also the most part of the toponymy of the Himara region is part and parcel of the Albanian onomastic treasury. This is proved not only by the inventory of the family names, but also by the patterns followed in their coinage, as well as by linguistic phenomena typical for the Albanian language.

The Albanian character of the Himara onomastic may be seen in names that are common to the Albanian people, inherited from the old times, e.g. *Lekë, Piro, Qezar, Likë, Damo*, etc., coming from the Illyrian-Epirote antiquity; in family names from the old proper and common names of the pagan Illyrian world as *Zot, Premt, Martë*, etc.; and in other patronyms derived from proper names of the early Christianity, as *Pal, Gjon, Gjin, Gjergj, Lazër, Todhër, Gjokë, Gjikkë, Mëhill, Mitër, Ndre*, etc. which have been preserved in the onomastic of Himara region

mainly as family names. Further, many of the stems of simple family names are nouns, adjectives or adverbs of the common vocabulary of Albanian, or of the Laberia dialect, e.g.: *Baba/Babe, Bonjako, Buco, Çeço, Duka/Dukaj, Kasneci, Mamija, Plaku, Prifti, Dhjako, Zoto/Zota, Premti* (from San Prenda, an Albanian saint), *Balla, Karo/Karaj, Kocka, Koka/Kokaj, Mboqe, Bica, Bua/Boit, Bufi, Bulla, Bullano, Bollanaj, Çakalli, Dacaj, Demi, Demka, Ndreri, Nerënxi, Pelikani, Pula/Pulo, Burgo, Boro, Çulla, Guri, Kashta, Kosi, Kuli/Kule, Kumi, Lapa, Lati, Mali/Malo/Malaj, Lule, Mërkuri, Palloshi, Rapo/Rapaj, Sheti/Sheto, Shia, Shuli, Vello, Jeto, Mai, Noti/Nota/Notaj/Note, Qendri/Qendraj, Vera, Veruari, Zboga/Zbogo; Bardhi, Buta/Butaj, Çali, Kreku/Kreka, Shkurti/Shkurta, Varfi/Varfaj, Vogli, Vongli, Zi, Kuri, Kote etc.*

This inventory of proper and family names makes the core part of the onomastic even of the encircling Lab villages, which have been converted to Islam about two to three centuries ago. When compared to the old onomastic fund of the Inner Laberia the onomastic of Himara, it is difficult to tell differences between them and to discern proper and family names of Himara from those of Inner Laberia. Not only two or three stem patronyms and toponyms, but also the most part of simple proper names and toponyms derived from them of the Himara region are found everywhere in our country.

The similarity is seen not only in the inventory, but also in the patterns of derivation of the patronyms of Himara. The two and especially three stem-composed family names are typical Albanian, and are found today in Catholic zones North of the country. The same can be said about the suffixes used to coin derived family names.

Finally, the phonetic changes undergone by the older part of the Himara onomastic, as can be seen from the following examples, such as *Gjon/Gjin* (Johannes), *Mërtir* (Martin), *Ndre(raj)* (Andrea), *Lazër* (Lazar), *Todhër* (Todor), *Shirok* (Saint Roques) etc., can be explained only with historical phonetic laws of the Albanian language. This is another proof that this treasury has been inherited passing orally from older generations of Albanians to younger ones.

All these facts taken together serve as an indisputable proof of the Albanian autochthony of bilingual inhabitants of the three above-mentioned villages, as well as of the entire region of Himara. Greek toponyms and of family names found in Himara can be explained as a result of the influence the Greek culture has exerted not only on this region, but also on entire border regions of Southern Albania.